
STATUTI I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “RASIV 2019” SH.P.K.

Eshte themeluar një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “**RASIV 2019** ” SH.P.K. Kjo shoqeri eshte themeluar ne date 12/12/2019 sipas Ligjit Nr. 9901, ate 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per një Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).

Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”i azhornuar;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;
- “QKR” –Qendra Kombetare e Regjistrimit ne Shqiperi.

KREU I Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1. Sot me date 12/12/2019, une, themeluesi, kam krijuar një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “ **RASIV 2019** ” SH.P.K.

1.2. Kjo shoqeri themelohet nga ortakut te meposhtem:

VISAR MUÇA , ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise, i biri i Flamurit, lindur me 07-08-1987, ne Shkoder, me shtetesi Shqipetare, mbajtes i kartes se identitetit numer I70807096B, numer leternjostimi 034225226, madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar:

Neni 2

Objekti

2.1. Shoqeria do te kryeje aktivitetin si me poshte:

Punime dhe sherbime ne fushen e ndertimit,Prishje punime ekzistuese dhe pastrim kantieri, Germime ,ndertime me mur guri ,mur tulle ,mur bloqe ,suvatime me krah dhe me pompe te brendshme dhe te jashtme ne lartesi te ndryshme, rikonstrukione objektesh,punime kartonxhesi,patinime dhe lyerje ndertesash, shtrim parketi,punime druri dhe punime metalike ,instalime elektrike dhe hidraulike etj.

Neni3

Kohezgjatja

3.1. Kohezgjatja e shoqerise do te jetë e pacaktuar.

Neni 4

Selia

4.1. Selia e shoqerise do te jete ne Shkoder, Rr.Qemal Dracini L:Vojo Kushi , Pallati 1261,hyrja e mesit, kat i peste , zona kadastrale nr. 8592 nr. pasurise: 1/393 + 2 - 14 telefon:+355672007578 .

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1. Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 10.000 (10 mijë) Lek. Pjesmarja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tij si me poshtë:
Kapitali fillestar i kompanise do te jete 10.000 (10 mijë) leke, te cilat mbeten prone e pronareve.

Visar Muça 100% te kuotave totale

Numri i kuotave eshte 1 me vlore 10 000 leke.

5.2. Kontributi i ortakut eshte ne para dhe i pa derdhur.ose ne natyre .

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

6.1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

6.2. Ne asje rast, shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;

b) shitblerjes;

c) trashegimise;

ç) dhurimit;

d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimmarres

- 8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 8.3. Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshtme:
- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendor ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
 - dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4. Ortaku mund te perfaqeshet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.
- 8.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.
- 8.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 9.1. Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

9.2. Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij nenii, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

10.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

10.2. Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

10.3. Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1. Asambleja e per gjithshme vodos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e per gjithshme vodos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

13.1. Asambleja e per gjithshme emeron një ose me shumë persona fizike si administratoren e shoqerise. Afati i emerimit, është 5 vjet, me të drejtë riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombetare te Regjistrimit.

13.2. Administratoret e një shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emerohen si administrator të një shoqerie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita është i pavlefshem.

13.3. Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme. Administrator i shoqerise është **Visar MUÇA**, biri i Flamurit, lindur me 7/08/1987, ne Shkoder, mbajtes i kartes se identitetit numer personal I70807096B

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

14.1. Administratoret kane të drejtë e detyrohen të:

a) kryejne të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarise tregtare të shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e per gjithshme;

b) perfaqesojnë shoqerine tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqerise;

ç) per gatisin dhe nenshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se

veprimitarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimitarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne të dhenat e detyrueshme të shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;

e) raportojne perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimitarine e shoqerise tregtare;

e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

14.2. Administratoret janë të detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqerise nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane një vlerë me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, që rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga një ortak pasuri, që kane vlerë me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, që rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3. Nese asambleja e per gjithshme emeron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkerisht shoqerine.

14.4. Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, që lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

15.1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

15.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

15.3. Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

15.3.1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemandje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

15.3.2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

15.3.3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregult e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

15.4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

15.5. Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrne padi penale kunder administratorit Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e pote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngriten e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

15.6. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.

Administratori ka te drejte te caktoje nje apo me shume perfaqesues te tij qe te mund te kryejne deri te njejtat funksione si administratori pa asnje limit, me prokure apo me autorizim, sipas ligjit.

KREU IV **Viti finanziar-ekspertet**

Neni 16

Viti Financiar

16.1. Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

17.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Ne perfundim te kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar pergaatit raportin me shkrim per nxjerjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V **Prishja –riorganizimi i shoqerise**

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

18.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

18.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

18.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjt 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

20.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

ORTAKU THEMELUES

VISAR MUÇA

V. Muça